



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:122905

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05604435

KPPP.nr.1463/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.”, me seli në Prishtinë, rr. “Robert Doll” nr.99, ndaj debitorëve N.T.P. “T...” B.I., i përfaqësuar nga pronari Xh.J., me seli në Pejë adresa, rr. “...” nr.8, Xh.J. me numër personal ... me adresë në rr. “... 3/A Pejë, A.G. me numër personal ... me adresë rr. “...” Pejë dhe N.N. me numër personal ... me adresë në Pejë, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson V.M., avokat nga Peja, duke vendosur sipas prapësimit të debitorëve të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 232/21 të datës 28.05.2021 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Blerim Baloku me seli të zyrës në Pejë, me datë 22.04.2024, jashtë seance merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorëve N.T.P. “T...” B.I., i përfaqësuar nga pronari Xh.J., Xh.J., A.G. dhe N.N., SHFUQIZOHET Urdhrit Përmbartimor P.nr. 232/21 i datës 28.05.2021 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Blerim Baloku, lidhur me borxhin prej 5,172.00€ (pesë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy euro) sipas Marrëveshjes mbi lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa Biznes kredit kartelës.
- II. SHFUQIZOHET Urdhrit Përmbartimor P.nr. 232/21 i datës 28.05.2021 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Blerim Baloku lidhur me borxhin prej 15,539.27€ (pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e nëntë euro e njëzet e shtatë cent) sa i përket debitorit N.N. lidhur me Marrëveshjen mbi Kredinë Nr.200712772 dhe Shtojca 1: Marrëveshja mbi Pengun Kolaterali i Luajtshëm i lënë peng nga Kredimarrësi, ndërsa për debitorët N.T.P. “T...” B.I., Xh.J. dhe A.G., sa i përket këtij borxhi MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr. 232/21 i datës 28.05.2021.

III. SHFUQIZOHET Urdhrit Përmbarrimor P.nr. 232/21 i datës 28.05.2021 i lejuar nga Përmbarruesi Privat Blerim Baloku lidhur me borxhin prej 5,309.48€ (pesë mijë e treqind e nëntë euro e dyzet e tetë cent) sa i përket debitorit A.G. lidhur me Marrëveshjen mbi Kredinë Nr.200709968 dhe Linjën e Kredisë 200709991 me Shtojcën: 1 Marrëveshja mbi Pengun Kolaterali i Luajtshëm, ndërsa për debitorët N.T.P. “T...” B.I., Xh.J. dhe N.N., sa i përket këtij borxhi MBETET NË FUQI Urdhri Përmbarrimor P.nr. 232/21 i datës 28.05.2021.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Përmbarruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.” (RBKO) ka lëshuar Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 232/21 të datës 28.05.2021, me të cilin e ka lejuar përmbarrimin në bazë të dokumentit përmbarrues Marrëveshjes mbi kredinë Nr. 200712772 me Shtojën 1: Marrëveshja mbi Pengun Kolaterali i Luajtshëm i lënë peng nga kredi marrësi/ Bashkë – kredi marrësi/ Garantuesi dhe Marrëveshjes mbi Kredinë Nr.200709968 dhe Linjën e Kredisë 200709991 me Shtojcën: 1 Marrëveshja mbi Pengun Kolaterali i Luajtshëm i lënë peng nga Kredi marrësi/ Bashkë – kredi marrësi/ Garantuesi, Marrëveshjes mbi lëshimin e Visa Biznes kredit kartelës dhe Konfirmimit të regjistrimit R-201800316-318 dhe R-20170919-140, duke detyruar debitorët që t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 15,539.27€ në bazë të Marrëveshjes mbi kredinë Nr. 200712772, borxhin prej 5,309.48€ në bazë të Marrëveshjes mbi Kredinë Nr.200709968 dhe Linjën e Kredisë 200709991 dhe borxhin prej 5,172.00€, për Marrëveshjen mbi lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa Biznes kredit kartelës, ku borxhi total është 16,020.75€, si dhe kamata e rregullt dhe kamatëvonesa që do të arrij deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore të gjithë këtë në afat prej 7 ditësh, përmes bllokimit të gjitha llogarive në të gjitha bankat komerciale apo përmes sekuestrimit dhe shitjes së kolateralit.

Debitorët brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, kanë paraqitur prapësim duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbarrimit. Debitori Xh.J. ka theksuar se nuk e kundërshton borxhin ndaj kreditorit mirëpo deklaroi se paraprakisht ishte dashur që t’i mundësohet pagesa e borxhit me këste pasi që për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore e ka të pamundur ta paguaj të gjithë borxhin njëherësh. Debitori A.G. ka kundërshtuar urdhrin përmbarrimor për faktin se ajo është garantuese vetëm në linjën e parë kreditore Nr. 200712772,

ndërkaq për marrëveshjet tjera ajo nuk mund të ketë cilësinë e debitores, për shkak se nuk ka qenë garantuese dhe se në cilësinë e garantueses ajo ka ofruar vetëm veturën e saj “Mercedes A” të vitit 2005 dhe jo kolateral tjetër apo xhirollogari bankare. Kanë shtuar se urdhri nuk është nxjerrë në përputhje me dispozitat ligjore pasi që dokumentet të cilat janë objekt i kësaj procedure nuk janë titull ekzekutiv. Gjykatës i kanë propozuar që Urdhri Përmbartimor P.nr. 232/21 i datës 28.05.2021, të anulohet dhe prapësimi i debitorëve të aprovohet në tërësi si i bazuar si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë në lartësi prej 780€ për përpilimin e prapësimit dhe 20€ për taksën gjyqësore.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorëve si të pabazuara, pasi që të njëjtat nuk janë mbështetur me asnjë provë të vetme duke e cilësuar kështu prapësimin në kundërshtim me dispozita ligjore të LPP-së. Tutje ka theksuar se propozimi për përmbartim i plotëson të gjitha kushtet ligjore pasi që i njëjti është iniciuar në bazë të dokumentit përmbartimorë dhe në të janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara me këtë ligj. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj ën tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, rekomandimeve të dhëna nga gjykata e shkallës së dytë dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi për arsyet si në vijim:

Gjykata gjeti se procedura përmbartimore është iniciuar në bazë të dokumentit përmbartimor Marrëveshjes mbi kredinë Nr. 200712772 me Shtojën 1:Marrëveshja mbi Pengun Kolaterali i Luajtshëm i lënë peng, Marrëveshjes mbi Kredinë Nr.200709968 dhe Linjën e Kredisë 200709991 me Shtojcën: 1 Marrëveshja mbi Pengun Kolaterali i Luajtshëm dhe Marrëveshjes mbi lëshimin e Visa Biznes kredit kartelës si dhe Konfirmimit të regjistrimit të pengut R-201800316-318 dhe R-20170919-140.

Nga provat në shkresa të lëndës gjen se Marrëveshjes mbi lëshimin e Visa Biznes kredit kartelës, nuk i është bashkangjitur shkresave të lëndës dhe se e njëjta nuk përbën dokument përmbartimor, pasi që neni 21 i LPP-së ka përcaktuar se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*, po ashtu neni 36 i LPP-së

parasheh se: *“1. Së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmëris për përmbarrueshmëri.”.*

Andaj, gjykata në përputhje me nenin 43, par.4 të LPP-së ku se: *“...Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarrueshmërisë së nxjerrë nga përmbarruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarrimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbarruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarrim nga përmbarruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”,* gjykata vendosi të shfuqizoj Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 232/21 të datës 28.05.2021, lidhur me borxhin prej 5,172.00€ (pesë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy euro) sipas Marrëveshjes mbi lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa Biznes kredit kartelës, pasi që gjeti se nuk janë plotësuar kushtet për lejimin e përmbarrimit.

Gjykata konstatoi se Marrëveshja mbi Kredinë Nr.200712772 dhe Shtojca 1: Marrëveshja mbi Pengun Kolaterali i Luajtshëm i lënë peng nga Kredimarrësi është nënshkruar nga kreditori Raiffeisen Bank Kosovo Sh.A. dhe N.T.P. T... si kredimarrës, Xh.J. si garantues personal dhe A.G. si garantues, ashtu që gjykata vlerësoi se lejimi i urdhërit përmbarrimor ndaj debitorit N.N. lidhur me Marrëveshja mbi Kredinë Nr.200712772 dhe Shtojca 1: Marrëveshja mbi Pengun Kolaterali i Luajtshëm i lënë peng nga Kredimarrësi është i kundërligjshëm ashtu që gjykata vendosi që të shfuqizojë pjesërisht urdhërin përmbarrimor në raport debitorit N.N. lidhur me këtë marrëveshje, përkatësisht për borxhin në lartësi prej 15,539.27€.

Gjykata po ashtu gjeti se nga dokumentet e propozuara për përmbarrim, rezulton se debitorit A.G. është garantuese vetëm në Marrëveshjen mbi kredinë Nr. 200712772 me Shtojcën 1: Marrëveshja mbi Pengun Kolaterali i Luajtshëm, ku sipas Konfirmimit të regjistrimit R-201800316-318 ka lënë peng veturën e tipit “Mercedes” të vitit 2005, ndërkaq nuk rezulton si nënshkruese në Marrëveshjen mbi Kredinë Nr.200709968 dhe Linjën e Kredisë 200709991 me Shtojcën: 1 Marrëveshja mbi Pengun.

Andaj, meqenëse e njëjta nuk është nënshkruese e Marrëveshjen mbi Kredinë Nr.200709968 dhe Linjën e Kredisë 200709991 me Shtojcën: 1 Marrëveshja mbi Pengun, gjykata shfuqizoi Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 232/21 i datës 28.05.2021 në përputhje me nenin 43, par.4 të LPP-së sa i përket debitorit A.G., pasi që e njëjta nuk mund të ketë cilësinë e debitorit për borxhin prej 5,309.48€.

Gjykata vendosi të lë në fuqi Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 232/21 të datës 28.05.2021 të lejuar nga Përmbarruesi Privat Blerim Baloku, sa i përket borxhit prej 15,539.27€ për debitorët N.T.P. “T...” B.I., i përfaqësuar nga pronari Xh.J., Xh.J. dhe A.G., sipas Marrëveshjes mbi kredinë Nr. 200712772 me Shtojën 1:Marrëveshja mbi Pengun dhe Konfirmimit të regjistrimit të pengut Nr. R-201800316-318, si dhe borxhin prej 5,309.48€ për debitorët N.T.P. “T...” B.I., i përfaqësuar nga pronari Xh.J., Xh.J. dhe N.N., sipas dhe Marrëveshjes mbi Kredinë Nr.200709968 dhe Linjën e Kredisë 200709991 me Shtojcën: 1 Marrëveshja mbi Pengun, dhe Konfirmimit të regjistrimit të pengut Nr. R-20170919-140.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përmbarrim, i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbarrues dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 22 dhe 27 të Ligjit 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, si dhe nenit 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, i cili përcakton se: *“2. Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.7., shtohet nën-paragrafi i ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.”*

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit privat bazohet në dokumentin përmbarrues përkatësisht Marrëveshjen mbi kredinë Nr. 200712772 me Shtojën 1:Marrëveshja mbi Pengun dhe Marrëveshjen mbi Kredinë Nr.200709968 dhe Linjën e Kredisë 200709991 me Shtojcën: 1 Marrëveshja mbi Pengun, të cilat marrëveshje në këtë procedurë përmbarrimore janë paraqitur në kopje të vërtetuara pranë zyrës noteriale të noterit Ylli S. Mekaj në Pejë, përmes LRP – nr. rendor 6728/2021, LRP – nr. rendor 6725/2021, LRP – nr. rendor 6726/2021 dhe LRP – nr. rendor 6727/2021, si dhe shkresave të lëndës i është bashkangjitur edhe Konfirmimi i regjistrimit të pengut R-201800316-318 dhe R-20170919-140.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi në përputhje me nenin 452 par.2 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, i cili përcakton se: *“452.2 Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej*

tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve.”, andaj meqenëse prapësimi i debitorëve është aprovuar pjesërisht, gjykata vendosi për shpenzimet e procedurës si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1463/22, datë 22.04.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.